



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju -  
Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 20 dhjetor 2016

Ref. Nr: *295/01B*

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të rregullorës nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave (Gazeta Zyrtare, Nr. 1,18 prill 2001), Udhëzimin Administrativ Nr. 21/2016, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria "subvencione dhe transfere", si dhe konkursin e shpalluar për këtë qëllim, merr këtë:

**V E N D I M**

1. APROVOHET Raporti i Komisionit për shqyrtimin e aplikimeve për subvencione, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i datës 12.12.2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT për zbatimin e këtij vendimi në bazë të vlerësimeve dhe propozimeve të Komisionit për shumën e mbështetjes financiare dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë dhe pas realizimit dhe zbatimit të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 21/2016, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria "subvencione dhe transfere" dhe pas administrimit të konkursit përkatës për ndarjen e mjeteve nga kjo kategori, si dhe në zbatim të rekomandimit respektiv të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përkitazi me shfrytëzimin efikas, efektiv dhe ligjor të pasqyrave financiare nga kjo kategori buxhetore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Arsim *BAJRAMI*, ministër





Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Qeveria/Vlada/Government

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTRASITVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	Alush Istogu, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm në MASHT <i>A Istogu</i>				
CC:					
NGA/OD/FROM:	Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Subvencione Ferit Idrizi, kryesues <i>F Idrizi</i> Enver Mekolli, anëtar <i>E Mekolli</i> Lulavere Behluli, anëtare <i>L Behluli</i> Kushtrim Kozmaqi, anëtar <i>K Kozmaqi</i> Elhame Shabani, anëtare <i>E Shabani</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi shqyrtimin e aplikacioneve				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	204	Lokacioni: Kucni: Extension:	MASHT	Data: Datum: Date:	12.12 2016
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Bazuar në vendimin Nr. 219/01B për emërimin e Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve për subvencione, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i përbërë nga Ferit Idrizi, kryesues, Enver Mekolli anëtar, Lulavere Behluli anëtar, Kushtrim Kozmaqi anëtar, dhe Elhame Shabani anëtare, shqyrtoi dhe analizoi 37 projekte të aplikantëve në fusha të ndryshme të arsimit. Komisioni në përbërjen e lartshënuar, si kriter bazë për ndarje të mjeteve mori

relevancën, qëllimin dhe objektivat e projekteve të aplikantëve. Duke u bazuar në këto kritere, Komisioni konstatoi se nga 37 projekte, 12 nga to i plotësojnë kriteret për mbështetje financiare, ndërsa 25 nga to refuzohen në mungesë të relevancës, qëllimit dhe objektivave. Bazuar në relevancën e projekteve dhe rezultatet e pritshme, komisioni nxjerr rekomandim për mbështetje financiare të këtyre projekteve sipas përqindjes:

1. (3) Projekti Atom, me titull Identifikimi dhe përkrahja e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme (cikli i gjashtë 2016-2017) mbështetet me 19.99 % të mjeteve, nga shuma e përgjithshme e kërkuar në vlerë prej 50,000.00€.
  2. (6) Projekti Propozimi i parashtruar nga OJQ-ve AVONET, Ferizaj, me titull “parandalimi i përdorimit të lëndëve narkotike tek të rinjtë” mbështetet me 40% të mjeteve, nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 9,900.00€.
  3. (7) Projekti me titull Studentet që dine të aplikojnë për punë parashtruar nga Unioni i studenteve të Kosovës, mbështetet me 80% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 4,730.00€.
  4. (11) Projekti me titull Ngritja e cilësisë në sistemin edukativ arsimor në Kosovë, parashtruar nga “Kosovo youth Centers Network”, mbështetet me 40% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 6,750.00€.
  5. (16) Projekti me titull mbështetje në edukim për fëmijë pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të braktisjes që marrin shërbime edukimi falas në “SOS KOPSHT”, mbështetet me 69.4 % të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 14,400.00€.
  6. (17) Projekti me titull Ndihme personave me aftësi të kufizuara, i parashtruar nga Adil Sahmulli, kryetar i shoqatës së personave me aftësi fizike dhe të kombinuara “HENDIKOS” mbështetet me 2000€.
  7. (18) Projekti me titull Robotika në arsimin e ulët – Ferizaj, i parashtruar nga Organizata Rinore Etika, mbështetet me 50% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 15,000.00€.
  8. (20) Projekti me titull Indikatorët shumë dimensional të dhunës në shkollë në Kosovë “Qendra për Shëndet Global” mbështetet me 30% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 19,840.00€.
  9. (22) Projekti me titull parandalimi i dhunës në shkollë i parashtruar nga koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve (KOMF) mbështetet me 40% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 8,720.00€.
  10. (35) Projekti me titull vëdijsimi i nxënësve të shkollave të regjionit të Prizrenit për sigurinë dhe privatësinë, rreziqet, pasojat dhe mënyrat e mbrojtjes në internet, mbështetet me 100% të mjeteve nga shuma e përgjithshme e kërkuar me vlerë prej 4,910.00€,
  11. (36) Projekti i Institutit për analizë dhe hulumtime sociologjike, parashtruar nga Fitim Shala, mbështetet në vlerë prej 2,500.00 €
  12. (37) Projekti me titull ICHAT mbështetet në vlerë prej 2,000.00 €.
- Vlera e përgjithshme e projekteve kap shumën **54,070.06**.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku  
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 10 tetor 2016

Ref. Nr: 218/01 B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), dispozitave të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria subvencione dhe transfere, merr këtë:


**V E N D I M**

- I. Emërohet Komisioni për shqyrtimin e aplikimeve për subvencione, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ferit Idrizi, kryesues,
  - 1.2. Enver Mekolli, anëtar,
  - 1.3. Lulavere Behluli, anëtare,
  - 1.4. Kushtrim Kozmaqi, anëtar,
  - 1.5. Elhame Shabani, anëtare,
- II. Obligohet Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, të propozojë kushtet dhe kriteret e konkursit për ndarjen e subvencioneve për personat fizik dhe juridik dhe më së voni me 17 tetor 2016 t'ia dërgoj Sekretarit të Përgjithshëm, për miratim dhe publikim në Web faqe të MASHT-it.
- III. Obligohet Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, të shqyrtoj aplikacionet dhe dokumentet e aplikuesve për subvencione brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh pas mbylljes së konkursit për aplikim.
- IV. Komisioni i veçantë ka përgjegjësi për administrimin e procesit të konkursit, shqyrtimin e aplikacioneve, hartimin e raporteve (konstatimeve dhe rekomandimeve) të cilat nënshkruhen dhe i dërgohen autoritetit themelues të tij, vendosjes për formulën e shpërndarjes së subvencioneve në fusha sipas nenit 5 të

UA nr. 21/2016, si dhe shqyrtimin e ankesave brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve të përfituesve të bursave.

- V. Komisioni i veçantë ka përgjegjësi për sigurimin e punës transparente, objektive dhe vlerësimit profesional të aplikacioneve.
- VI. Obligohet Divizioni për Koordinim të Politikave dhe Statistika të krijoj bazën e të dhënave të kandidatëve që aplikojnë dhe projektet e tyre.
- VII. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, Ministër



**lu dërgohet:**

- Të emëruarve sipas këtij vendimi;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Arkivit të MASHT.